Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Rema Kompani shpk" të datës 21.09.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me mobileri urbane në parqe të Kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-26-7403-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Rema Kompani shpk" të datës 21.09.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me mobileri urbane në parqe të Kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-26-7403-1-1-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Kema Kompani shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 21.09.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me mobileri urbane në parqe të Kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-26-3071-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1: AK në DT ka kërkuar autorizimin, garancionin dhe katalogun nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për pozicionet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Përmes nenit 28 par. 7 të LPP është përcaktuar se të gjitha kërkesat në DT lidhur me produkte të caktuara që i referohen specifikave të caktuara teknike duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalente". Në formën siç janë përcaktuar aktualisht, të gjitha specifikat teknik janë të formuluara pa mundësinë e ekuivalencës (ose versione më të avancuara). Një formulim i tillë përbën shkelje flagrante të nenit 28 par. 7 të LPP. Për më tepër, kjo përbën edhe shkelje të nenit 7 të LPP pasi që pozicionet në formën aktuale mund të plotësohen vetëm nga një (1) prodhues i vetëm dhe natyrisht që një kufizim i tillë përbën diskriminim/favorizim të drejtpërdrejtë. Prandaj kërkojë nga AK që në FDT të përcaktojë shprehimisht se për të gjitha produktet e kërkuara me ST dhe veçanërisht ato pozicione për të cilat kërkohet autorizim, garancion dhe katalog nga prodhuesi, të lejohet edhe ofertomi me versione **"ekuivalente" ose më të "avancuara".**

Pretendimi 2: AK në DT ka përcaktuar kërkesën si në vijim: *5. Operatori Ekonomik para hapjës së tenderit duhet të dorëzoj mostrat për pozicionet 2, 3, 6, dhe 7 në paramasë.*

Përmes nenit 37 par. 1 të RRPP përcaktohet si vijon "*Dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertës*". Në rastin konkret kërkesa e DT për dorëzimin e mostrave përbën shkelje flagrante të kësaj dispozite për faktin që më herët në DT është kërkuar autorizimi, garancioni dhe katalogu i produkteve. Rrjedhimisht kërkesa shtesë edhe për dorëzimin e mostrave, jo vetëm që është e pabazuar në LPP/RRPP por edhe është e panevojshme si dhe krijon shpenzime që paarsyeshme për OE që po ashtu nuk gjen mbështetje ligjore në LPP/RRPP.

Për këto arsye kërkojmë nga AK që këtë kërkesë ta largojë në tërësi nga DT.

Pretendimi 3: AK në DT ka përcaktuar kërkesën si në vijim: "6. Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se prodhuesi i produkteve të ofruara është i certifikuar sipas standardeve ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001 dhe FSC-STD-50-001 V2.0".

Përmes një kërkimi të thjeshtë në internet, fillimisht duhet të sqarojmë kuptimin e këtyre certifikatave. Së këndejmi certifikatat ISO 9001, 14001 dhe 45001 janë të njohura ndërkombëtarisht dhe me të drejtë janë kërkuar nga AK sepse ndërlidhen me menaxhimin e kualitetit, menaxhimin e ambientit dhe me menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit.

> **ISO 9001, ISO 14001, and ISO 45001** are the three most common international management system standards that businesses use to control quality, environmental impact, and worker safety.
>
> **What Each Standard Covers**
>
> - ISO 9001: The Quality Management System (QMS) standard. It helps companies deliver consistent products and services, meet customer needs, and improve overall satisfaction. Citation ISO Certif... +2
> - **ISO 14001**: The Environmental Management System (EMS) standard. It helps organizations track and reduce their environmental footprint, manage waste and energy, and obey green laws. Universal Certi... +2
> - **ISO 45001**: The Occupational Health and Safety Management System (OHSMS) standard. It helps companies find workplace hazards, lower safety risks, and prevent worker injuries or illnesses.

Problemi (dhe pretendimi ynë) ndërlidhet vetëm sa i përket certifikatës FSC-STD-50-001 V2.0. Fillimisht duhet sqaruar se nuk kemi të bëjmë se standarde ISO. Konkretisht shkurtesa FSC nënkupton "Forest Stewardship Council" e cila është një OJQ ndërkombëtare ku Republika e Kosovës nuk është fare anëtare dhe e cila nuk ka aktivitet fare në vendin tonë. Tutje duhet sqaruar se kjo certifikatë që lëshohet nga kjo OJQ (që nuk është ISO STANDARD) nuk ka të bëjë fare me aktivitetin e prokurimit por ka të bëj me mënyrën e përdorimit të markave tregtare nga përdoruesit. Për më tepër, më sipër në DT është kërkuar autorizimi i prodhuesit, garancioni dhe katalogu nga prodhuesi. Pra nuk ka logjikë (është krejt paradoksale) që kërkohet edhe autorizim nga prodhuesi edhe certifikatë për përdorimin e markave tregtare, pa çka se ky aktivitet ka të bëjë me mobileri

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111

urbane dhe nuk ka asnjë ndërlidhje me markat tregtare.

FSC
Forest Stewardship Council®



Requirements for use of the FSC® trademarks by certificate holders

FSC-STD-50-001 V2-0

Prandaj kërkojmë nga AK që të largojë në tërësi nga kërkesa e DT pjesën ku kërkohet certifikata FSC-STD-50-001 V2.0.

Pretendimi 4: AK në DT ka kërkuar "7. Operatori Ekonomik duhet të disponojë së paku 1 (një) kamionet me lift, me peshë maksimale prej 840 kg". Nga paramasa/projekti, asnjë funksion mund të realizohet nga kamioneta me liftë pasi që asnjë nga pozicionet e mobilerisë urbane nuk do të vendosen në katin e dytë apo katet tjera të objekteve të caktuara. Prej vet titullit të aktivitetit të prokurimit kuptohet që mobilera urbane do të vendoset në qytet. Prandaj kamioneta me lift nuk ka asnjë funksion të vetëm.

Për këtë arsye kërkojmë nga AK që ta largojë në tërësi këtë kërkesë nga DT. Mirëpo nëse AK sërish insiston që të mbajë këtë kërkesë në DT, të paktën duhet të largohet kufizimi i peshës dhe të riformulohet saktë kërkesa. Nëse krejt hipotetikisht do të kishte për t'u vënë në funksion kjo makineri, shumica e produkteve kanë peshë me qindra kilogramë prandaj një makineri që i ka max 840 kg (pra më pak se 840 kg), cilin produkt do të kishte kapacitet për t'a lëvizur nga vendi? Prandaj kufizimi i peshës duhet të largohet ashtu që të përcaktohet si shembull. "minimum 840 kg" (dhe jo max. 840 sic është tani). Po ashtu kërkesa edhe duhet të riformulohet sepse në versionin aktual nuk dihet nëse pesha ngritëse duhet të jetë 840 kg apo e gjithë pesha e makinerisë duhet të jetë 840 kg. Po ashtu në kërkesë përdoret termi "kamionet me lift". Duke qenë se termi lift nënkupton diçka tjetër në jetën e përditshme (ashensor) dhe si term (lift) nuk është fare shqip, është dashur që të shtohet "kamionet me korpë".

Mirëpo përfundimit pretendimi ynë është kjo kërkesë të largohet në tërësi sepse është e kundërligjshme dhe jo vetëm kufizuese apo e formuluar gabimisht.

Lidhur me pretendimin e parë, përmes nenit 28 par. 7 të LPP përcaktohet se produktet e përcaktuara në DT apo ST duhet të pranohen nga AK edhe si ekuivalente. Prandaj miratohet propozimi i parë ashtu që AK do të korrigjoj DT duke përcaktuar shprehimisht në DT se lejohet edhe dorëzimi i produkteve ekuivalente.

Lidhur me pretendimin e dytë, duke marrë parasysh natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, dhe duke u bazuar në nenin 37 par. 1 të RRPP, konsiderojmë se në këtë aktivitet dorëzimi i mostrave është i panevojshëm. Prandaj miratohet pretendimi 2.

Lidhur me pretendimin e tretë, parashtruesi ka prezantuar argumente të matshme dhe bindëse sipas të cilave mund të konfirmohet se certifikata FSC-STD-50-001 V2.0 nuk është e domosdoshme për këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj miratohet pretendimi 3.

Lidhur me pretendimin 4, kamioneta me lift është pajisje e domosdoshme për realizimin e projektit mirëpo AK do të korrigjoj kërkesën duke lejuar që diferenca në mes të minimumit dhe maksimumi të peshës së ngarkesës të jetë më e madhe për të garantuar

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111

se nuk do të ketë diskriminim/favorizim të OE. Prandaj kërkesa për këtë pajisje do të riformulohet si vijon "7.Operatori Ekonomik duhet të disponojë së paku 1 (një) kamionetë me liftë me peshë maksimale të ngarkesës së lejuar deri në 900kg". Pra ky pretendim miratohet vetëm si pjesërisht i bazuar.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.09.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111